

Debat: "Çfarë mund të jetë e ardhmja e Prishtinës"?

Prishtina, vetëm emrin e ka kryeqytet

"Strategjia 2020" është një vizion utopik dhe i paqartë. Në këtë plan përdoren supozime të pabaza dhe të dhëna të paqëndrueshme, tha Verena Knaus, analiste nga ESI

VISAR KRASNIGI
Prishtinë, 9 qershor - Drejtuesit e Iniciativës Kosovare për Stabilitet (IKS) dhe European Stability Initiative (ESI), të enjten mbrëmë kanë zgjedhur Muzeun e Kosovës për të debatuar mbi qeverisjen dhe planifikimin e kryeqytetit. Në panel, Ismet Beqiri, kryetar i KK të Prishtinës, dhe Ardan Gjini, ministër i Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, u janë përgjigjur pyetjeve nga shoqëria civile. Në studimin e bërë nga këto dy organizata janë përmblodhur shumë shembuj nga dështimet

e qeverisjes së Prishtinës. Verena Knaus, analiste nga ESI, tha se "Strategjia 2020" është një vizion utopik dhe i paqartë. "Në këtë plan përdoren supozime të pabaza dhe të dhëna të paqëndrueshme". Ndërsa Besa Shahini, drejtoreshë ekzekutive e IKS-it, nuk është pajtuar me planet e reja që parashohin rënimin e një numri të madh të ndërtesave ekzistuese. Shahini dhe Knaus kërkuar të dinë se sa kohë i duhet Prishtinës që të bëhet sikurse Lubjana. Por, kryetari Beqiri nuk është pajtuar me konkluzionet e këtyre

organizatave. "Prishtina nuk mund të bëhet si Lubjana... Prishtina vetëm me emër është kryeqendër, ngase kjo nuk është e rregulluar as juridikisht dhe as financiarisht". Ai krahasoi buxhejin e Prishtinës me atë të kryeqyteteve të rajonit. "Tirana ka buxhet 85 milionë dollarë, kurse Prishtina ka vetëm 9 milionë". Astrit Hajrullahu, arkitekt nga Prishtina, i tha se fjala problemet e trashëguara duhet të hiqet nga mendja e udhëheqësve. "Kjo fjallë po përdoret që tetë vjet". Beqiri i tha se nuk po mund të lirohen nga problemet që janë bërë nga e kaluara. Banori Bakir Kastrati tha se është i zhgënjyer me udhëheqësit e Prishtinës. "Prishtina i ngjan një varëze masive. Nuk

funksionon ligji". Leon Malazogu i tha se po i pengon mbijllia e korzoz në rrugën "Nëna Terezë", sepse nga kjo po krijohet tollovi në rrugën Agim Ramadani. Beqiri i tha se pasi të gjendet një zgjidhje, korzoza do të mbyllet krejt. Muhamet Mustafa, kryetar i Institutit "Rinvest", tha se çdo strategji ka nevojë për rishikim. "Kryeqytetit i mungon mbushja me kulturë".

Gjini: Dëm i madh nëse dështojnë planet e Prishtinës

Ardan Gjini, ministër i APH, kërkoi të ketë një ndarje në mes njësive të planifikimit afatgjatë dhe atyre të menaxhimit urban, në mënyrë që të kotë zgjidhje më të shpejta. Gjini i tha se Prishtinës nuk guxojnë t'i dështojnë planet. "Plane utopike nuk ka. Nëse dështojnë këto plane, do t'i shkaktohet një dëm i madh jo vetëm Prishtinës, por edhe Kosovës".

Dardani nervozoi Beqirin

Dardan Islami, nga radio "Urban FM", ka qenë i vetmi që e ka "nervozuar" Beqirin. Ai i tha kryetarit se të gjithë inspektorët janë të korruptuar. "Pse ata kur po dinë më vjedh nuk po dinë më i vjedh taksat nga qytetarët". Kritikoi kryetarin Beqiri për një grup truporësh që merr pas veti. Tha se është shumë vështirë të realizohet një takim me të. Në revanshin e tij, Beqiri i tha se qasja provokative nuk ia mundëson Dardanit takimin me të.



Foto: BOMENI NIMANI



TELEFONA